



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

Nr. 50 Datë 01 / 10 /2025

“ Për dhënie të mandatit të Këshilltarit”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “ Përvetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ,neni 49 pika1,pika 2,; neni 50 pika 1,neni 54 shkronja “j” , neni 55 pika 3,; sipas listës shumëemërore të kandidatëve për Këshillin Bashkiak Dibër, Partia Socialiste e Shqipërisë,Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **01.10.2025** me 17 vota pro,0 kundër dhe 1 apstenim:

VENDOSI:

1. Dhënien e mandatit të këshilltares **znj.Aida Hamzi Murrja**, Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Njoftohet për vendimin e lartëcituar KQZ dhe Prefekti i Qarkut Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall sot me datë **01.10.2025**.

Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga 6038
KQT dhe mban nga dërguesi nr. prot
datë 10.09 2025 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes(lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 2449/1 datë
15.09 2025.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z
-Znj/Z Student të Fakultit Bashkiak
-Znj/Z
-Znj/Z

me porosinë:

Administratori praktikës Bashkiak E. J. J.

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes,...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar
do të jetë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 15.09 2025

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS



2569/
15/09/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 11/09/2025

Nr. 6038

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Dibër ✓

Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Partisë Socialiste të Shqipërisë

Sheshi "Austria" Tiranë

Zj. Aida Hamzi Murrja

Peshkopi, Dibër

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 04.09.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Aida Hamzi Murrja.


Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1372, datë 04.09.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe në urdhër)

Anila RUÇO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më
Nr.

Data: 4.9.2025

Nr: 1372

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**PLOTESIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË", ZJ. AIDA HAMZI MURRJA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2449 prot., datë 03.07.2025, Këshilli i Bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Shirete Murat Cibaku, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 17, zj. Aida Hamzi Murrja.

Me shkresën nr. 5504, prot., datë 09.07.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër, zj. Aida Hamzi Murrja, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 4.9.2025 Nr:1372
Ora:12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Aida Hamzi Murrja"

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DI-PS-18644_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Aida Hamzi Murrja, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 5654 prot., datë 22.07.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 5653 prot., datë 22.07.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Aida Hamzi Murrja.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 2122/1 prot., datë 31.07.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Aida Hamzi Murrja, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 11676/1 prot., datë 25.07.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Aida Hamzi Murrja, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Aida Hamzi Murrja, në Këshillin e Bashkisë Dibër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"



V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Aida Hamzi Murrija.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

